'Thuaj, nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, i Cili është i Vetëm, pa ortak, Allahu është më i Madhi, Atij i takon falënderimi i shumtë, i Pastër është Allahu, Zoti i botëve, nuk ka ndryshim dhe as fuqi veçse nëpërmjet Allahut të Gjithëfuqishmit, të Urtit.'

Nga Sa'di (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet se ka thënë: "Një beduin erdhi te Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: 'Më mëso disa fjalë që t'i them!' Pejgamberi tha: 'Thuaj, nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, i Cili është i Vetëm, pa ortak, Allahu është më i Madhi, Atij i takon falënderimi i shumtë, i Pastër është Allahu, Zoti i botëve, nuk ka ndryshim dhe as fuqi veçse nëpërmjet Allahut të Gjithëfuqishmit, të Urtit.' Beduini tha: 'Këto fjalë janë për Zotin tim, po për mua çfarë ka?' Pejgamberi i tha: 'Thuaj: O Allah, më fal, më mëshiro, më udhëzo dhe më furnizo!'"

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Një burrë nga banorët e shkretëtirës i kërkoi Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) t'i mësonte një dhikër që ta bënte dhe Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) i tha: Thuaj: "Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, i Cili është i Vetëm, pa ortak." Pejgamberi e filloi porosinë me dëshminë e teuhidit, kuptimi i së cilës është se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut. "Allahu është më i Madhi!" D.m.th: Allahu është më i madh dhe më madhështor se çdo gjë. "Falënderimi i shumtë i takon Allahut!" D.m.th: Allahut i takon falënderimi i shumtë për cilësitë, veprimet dhe mirësitë e Tij të panumërta. "I Pastër është Allahu, Zoti i botëve!" D.m.th: Ai është i pastër nga çdo e metë. "Nuk ka ndryshim dhe as fuqi veçse nëpërmjet Allahut, të Gjithëfuqishmit, të Urtit." D.m.th: Nuk kalohet nga një gjendje te tjetra, veçse falë Allahut, falë ndihmës dhe orientimit të Tij. Burri tha: “Këto fjalë janë për Zotin tim për ta përkujtuar dhe madhëruar Atë. Po unë çfarë lutjesh mund të bëj për veten time?” Dhe Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) i tha: "Thuaj: OAllah, më fal mua!" Me anë të fshirjes dhe mbulimit të mëkateve. "Dhe më mëshiro!" Duke më sjellë dobi dhe mirësi në fe dhe në jetën materiale. "Dhe më udhëzo!" Duke më orientuar te gjendja më e mirë dhe rruga e drejtë. "Dhe më furnizo me rrizk!" D.m.th: më furnizo me pasuri të pastër, me shëndet, me mirëqenie dhe me çdo gjë të mirë.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/6112